



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.1, datë 04/03/2022

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS “PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR AMBALLAZHIM NË SHISHE OSE ENË”,
SUBJEKTIT “FERRA DISTRIBUTION ” SH.P.K”.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, VKM-së nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së Këshillit të secilit prej tyre”, VKM-së nr.550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

KONSTATOI SE:

I. Në datën 17.07.2020 subjekti “Ferra Distribution” shpk paraqiti pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat, kërkesën për marrjen e lejes “Për përdorim të burimit ujor”, me objekt “Ambalazhim i ujit në shishe ose enë” duke kërkuar shfrytëzimin e ujërave të burimit Gurraj të shoqëruar bashkë me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës sipas VKM-së nr.416, datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur rezultuan mangësi dhe ZABU Ishëm-Erzen-Mat me shkresën nr. 294/1 prot., datë 22.07.2020 njofton subjektin për plotësimin e dokumentacionit. Subjekti “Ferra Distribution” shpk me shkresën nr. 294/3 prot., datë 25.11.2020 ka plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar.

ZABU Ishëm-Erzen-Mat me shkresën nr.510 prot., datë 07.12.2020, “Dërgim dokumentacioni”, dërgoi për oponencë në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të paraqitur nga subjekti.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, AMBU me shkresën nr.510/1 prot., datë 18.12.2020, dërgoi relacionin me konstatimet përkatëse, ku rezultoi se dokumentacioni i dërguar nga subjekti ishte i plotë dhe mund të vijohej me ndjekjen e procedurës për propozimin e kërkesës për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Basenit Ujor.

Në zbatim të nenit 50, pika 2 të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, të VKM-së nr.696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre” dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.06.2019 “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Basenit Ujor” kërkesa për leje së bashku me relacionin dhe dokumentacionin shoqërues përkatës u propozua për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen përkatëse të KBU-së Mat, e cila u zhvillua më datë 12.04.2021.

Rezulton se me hyrjen në fuqi të VKM-së nr.550 datë 15.07.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, e cila shfuqizonte VKM –në nr.416, datë 13.05.2015 (në fuqi në kohën e paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të subjektit) në dispozitat tranzitore të këtij vendimi, përcaktohej se kërkesat e dorëzuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi shqyrtohen nga ZABU-të përkatëse, sipas kushteve të posaçme dhe dokumenteve shoqëruese të parashikuara në vendimin nr. 416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave. Në këtë rast, subjektet detyroheshin të plotësojnë dokumentacionin teknik e ligjor brenda datës 31 dhjetor 2020.

Referuar parashikimit të mësipërm në kushtet kur dokumentacioni i subjekti u plotësua brenda datës 31 dhjetor 2020. ZABU Ishëm-Erzen- Mat propozoi për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të KBU Mat, e cila u zhvillua më datë 12.04.2021. Në këtë mbledhje KBU Mat vendosi që kjo kërkesë të shqyrtohej në mbledhjen e ardhshme pasi duke qënë se burimi ujor ndodhej në bashkinë Klos, ishte i nevojshëm qëndrimi i përfaqësuesit të Bashkisë Klos, i cili nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje.

Mbledhja e radhës e KBU Mat u zhvillua më datë 21.06.2021 dhe kërkesa e subjektit ka qënë sërish pjesë e rendit të ditës. Në këtë mbledhje përfaqësuesi i Bashkisë Klos pretendoi se në kushtet kur ishte i sapo emëruar si anëtar i KBU Mat, se nuk njihej me dokumentacioni e kësaj kërkesë dhe kërkoi kohë për një qëndrim të shprehur të Bashkisë Klos. Në këto rrethana KBU Mat vendosi shtyrjen e vendimmarrjes në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e radhës së KBU Mat u zhvillua më datë 30.09.2021 dhe kërkesa e subjektit ka qënë sërish pjesë e rendit të ditës. Përfaqësuesi i Bashkisë Klos ka shpjeguar se bashkia Klos është në fazën e një projekti të një ujësjellësi dhe kanale vaditëse, ku përfshihet dhe burimi që kërkohet nga subjekti dhe është i vetmi burim që furnizon me ujë një zonë e cila ka 3 mijë banorë. Me qëllim për tu njohur me projektin e bashkisë KBU Mat e vlerësoi të nevojshme t'i lihej kohë Bashkisë Klos që të paraqiste projektin në mbledhjen e ardhshme, dhe vendosi shtyrjen edhe një herë të vendimarrjes për këtë kërkesë.

Si përfundim në mbledhjen e rradhës së KBU Mat të zhvilluar në datën 04.03.2022, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit për marrjen e lejes për përdorim burimi ujqor dhe pasi u njoh me projektin e Bashkisë Klos nëpërmjet përfaqësuesit të kësaj bashkie, për furnizimin me ujë të popullsisë nga i njëjti burim ujqor që kërkohet të shfrytëzohet nga subjekti "Ferra Distribution" shpk, rezultoi se:

- Bashkia Klos ka dy projekte, i pari për ujësjellësin e Xibrës, që do të furnizojë 6 fshatra me rreth 3500 banorë dhe do të furnizohet nga përroi Guri i Bardhë, dhe projekti i dytë, "Projekti i shtatë fshatrave", i cili do të furnizohet nga "përroi i Lopës".
- Projekti i dytë është llogaritur gabim nga projektuesi dhe nevojitet më tepër sasi ujë, të cilën do ta marrë nga përroi Guri i Bardhë, Xibër.
- Të dy projektet do të rishikohen dhe do të ndërtohet një ujësjellës me dy vepra marrje, gjithashtu janë bërë prokurimet nga firma kontraktuese pritet dokumentacionin. Projektin e Gurit të Bardhë bashkia e disponon, por duhet rishikuar. Do të shtohet sasia për furnizimin me ujë.
- Nevoja për ujë të pijshëm është më e madhe nuk mund të jemi dakord për dhënien e këtij burimi pa përfunduar projekti i furnizimit me ujë të pijshëm.
- Uji i burimit Guri i Bardhë do të përdoret edhe për vaditje nga fshati Xibër-Murrizë dhe është i vetmi burim që lag zonën aty.
- Si konkluzion, do të cënohej përdorimi i ujit të pijshëm për banorët.

Kërkesa e subjektit nuk u miratua me 12 vota kundër (votuan refuzimin e kërkesës) dhe një votë pro (për miratimin e kërkesës).

II. Baza Ligjore

- Ligji nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar;
- VKM nr. 416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore";
- VKM nr.550 datë 15.07.2020 "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe

ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”;

- VKM nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”.
- Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.06.2019 “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Basenit Ujor Mat bazuar në gjurmën (ç), të pikës 14, të Kreut IV, të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020, dhe në vendimin nr.6, datë 12.06.2019, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”, të Këshillit Kombëtar të Ujit,

V E N D O S I:

Refuzimin e kërkesës për leje për përdorim të burimit ujor për ambalazhim në shishe ose enë, subjektit “Ferra” shpk, me vendndodhje Xibër-Murriz, Bashkia Klos, sipas këtyre koordinatave:

X=504086 Y=4589069 Z=1133 m.m.n.d

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

